



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 57

Tiranë – E mërkurë, 18 mars 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit nr. 7, datë 10.3.2026	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.....	4071
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 9, datë 12.3.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.....	4071
Urdhër i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 168, datë 13.3.2026	Për zëvendësimin e përkohshëm për nënshkrimin e dokumenteve në emër të Sekretarit të Përgjithshëm.....	4076
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 239, datë 5.3.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	4076
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 240, datë 5.3.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës....	4077
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 280, datë 12.3.2026	Për delegim kompetence.....	4078
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 56, datë 20.2.2026	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, për vitin 2026.....	4079
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 57, datë 20.2.2026	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV, për vitin 2026.....	4080

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 58, datë 20.2.2026	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2026, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë ‘HEC Treska’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 24.7.2013”	4082
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 59, datë 20.2.2026	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 36, datë 4.2.2026, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë ‘Hydro Power Plant of Korca’ sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 5.4.2012”	4083
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 60, datë 20.2.2026	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 39, datë 4.2.2026, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë ‘Peshku-Picar 1’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 2.3.2012”	4085
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 61, datë 26.2.2026	Mbi kërkesën e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	4086
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 62, datë 26.2.2026	Mbi kërkesën e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	4087
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 63, datë 26.2.2026	Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2026.....	4088
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 64, datë 26.2.2026	Mbi shtyrjen e vendimarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë “Volton” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me pikën e matjes “Tona ALB/6390”...	4100
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 8, datë 4.3.2026	Për licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës-kanalizime Kamzë sh.a.....	4101



UDHËZIM

Nr. 7, datë 10.3.2026

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN
NR. 12, DATË 30.6.2023, TË MINISTRI
TË ARSIMIT DHE SPORTIT, “PËR
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E
ARSIMIT TË LARTË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe urdhrit nr. 580, datë 11.11.2025, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Armela Baka”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë:

a) Pas shkronjës “d” të pikës 1, të kreut X, shtohen shkronja “dh”, si më poshtë:

“dh) Përgjithshëm për vitin akademik 2025–2026, kandidatët për student me diploma të huaja që regjistrohen në programe të përbashkëta studimi të arsimit të lartë, për të cilët vendi i origjinës ka ndryshuar kriteret e pranimit, kanë të drejtën të aplikojnë për regjistrim deri më datë 31 mars 2026.”.

b) Pas pikës 2, të kreut X, shtohen pikat 2/1 dhe 2/2, si më poshtë:

“2/1 Përgjithshëm për vitin akademik 2025–2026, për kandidatët e regjistruar në një program të përbashkët studimi të arsimit të lartë, për të cilët vendi i origjinës ka ndryshuar kriteret e pranimit dhe që kanë detyrimin për njohjen dhe njehsimin e diplomës së huaj, QSHA-ja përfundon procesin e njohjes dhe njësimit të këtyre diplomave brenda datës 31.5.2026.

2/2 LAL-të përcjellin në QSHA, brenda datës 10 qershor 2026, dokumentet e njohjes dhe të njësimit të diplomave të tyre, të lëshuara nga QSHA-ja.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimit Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar,

drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Armela Baka

UDHËZIM

Nr. 9, datë 12.3.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN E PËRGJITHSHËM
NR. 26, DATË 8.9.2023, “PËR TATIMIN
MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 70, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e përgjithshëm të ministrit të Financave, nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

1. Pas pikës 8.8, shtohet pika 8.9, me përmbajtjen si më poshtë:

“8.9. Në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 8 të ligjit, artistët që nuk janë shtetas të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nëse plotësojnë ndonjë nga kushtet e përcaktuara në shkronjat “a” deri në “d”, nuk konsiderohen rezidentë tatimore në Republikën e Shqipërisë për një periudhë 24-mujore.

Kjo periudhë fillon nga data e hyrjes së tyre të parë në territorin e Republikës së Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë artistike dhe zbatohet pavarësisht numrit të ditëve të qëndrimit gjatë saj. Afati 24-mujor vijon të llogaritet edhe në rast ndërprerjesh të përkohshme të qëndrimit brenda territorit dhe nuk rifillon në rast daljeje dhe rihyrjeje në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pas përfundimit të periudhës 24-mujore, statusi i rezidencës tatimore të individit përcaktohet në përputhje me kriteret e tjera të parashikuara në nenin 8 të ligjit.

Me kërkesë të administratës tatimore, artisti ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin që provon hyrjen për herë të parë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe periudhën e tij të qëndrimit në Shqipëri.

**Shembulli 1**

Këngëtari i njohur me initiale “A.A.”, shtetas italian, hyn për herë të parë në territorin e Republikës së Shqipërisë më datë 1 mars 2026 për të zhvilluar një veprimtari artistike. Gjatë 24 muajve, nga momenti i hyrjes për herë të parë, ai qëndroi në Shqipëri për më shumë se 183 ditë në secilin vit kalendarik.

Në zbatim të pikës 8.9 të këtij udhëzimi, këngëtari “A.A.” nuk do të konsiderohet rezident tatimor në Republikën e Shqipërisë për një periudhë 24-mujore, e cila fillon më 1 mars 2026 dhe përfundon më 29 shkurt 2028. Gjatë kësaj periudhe, ai trajtohet si tatimpagues jorezident dhe tatohet vetëm për të ardhurat me burim në Republikën e Shqipërisë, sipas dispozitave të nenit 58, pika 2, të ligjit. Në përfundim të periudhës 24-mujore, duke filluar nga data 1 mars 2028, përcaktimi i rezidençës tatimore të tij bëhet sipas rregullave të përgjithshme të parashikuara në ligj.”.

2. Në pikën 11, bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) Në fjalinë e parë, shkronja “P” zëvendësohet me shkronjën “g”.

b) Pas pikës 11.9, shtohet pika 11.10 me përmbajtje:

“11.10 Të ardhurat që përfiton një person fizik nga sponsorizimet përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale vetëm deri në masën e kufizimeve të përcaktuara në nenin 50, pika 1, shkronja “p” të ligjit.

Përjashtimi zbatohet vetëm për pjesën e sponsorizimit, që plotëson kushtet dhe kufizimet ligjore për njohjen si shpenzim i zbritshëm të sponsorizimit nga sponsorizuesi. Çdo shumë që tejkalon kufirin e lejuar, sipas dispozitës së sipërcituar, konsiderohet e ardhur e tatueshme dhe i

nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale, sipas dispozitave ligjore.

Për qëllime të zbatimit të kësaj dispozite, personi fizik përfitues duhet të disponojë dhe, me kërkesë të administratës tatimore, të paraqesë dokumentacionin, si më poshtë:

a) kontratën e sponsorizimit të lidhur ndërmjet sponsorizuesit dhe personit fizik përfitues, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sponsorizimet;

b) dokumentin bankar që provon kryerjen e pagesës së sponsorizimit ose fatura e shitjes së mallit në vlerën e kostos;

c) vërtetim nga sponsorizuesi për shumën e sponsorizimit të njohur si shpenzim i zbritshëm, sipas kufizimeve të nenit 50, pika 1, shkronja “p” të ligjit. Ky vërtetim i dorëzohet përfituesit për qëllime të kryerjes së deklaratimit dhe duhet të përcaktojë:

i. shumën e sponsorizimit që njihet si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin, e cila korrespondon me shumën që do t'i njihet përfituesit si e ardhur e përjashtuar; si dhe

ii. në rast se sponsorizimi tejkalon kufizimet ligjore, shumën që nuk njihet si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin, e cila korrespondon me pjesën e sponsorizimit që i njihet përfituesit si e ardhur e tatueshme.

d) çdo dokument tjetër mbështetës që mund të ketë, që provon natyrën dhe përputhshmërinë ligjore të sponsorizimit.

Në mungesë të dokumentacionit të plotë dhe të vlefshëm, ose kur konstatohet se nuk plotësohen kufizimet ligjore për njohjen e sponsorizimit, si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin, e gjithë shuma ose pjesa përkatëse konsiderohet e ardhur e tatueshme për përfituesin.

Shembull

Shoqëria “A.B.” sh.p.k., gjatë vitit tatimor 2026, ka kryer 2 sponsorizime kundrejt 2 përfituesve, konkretisht:

- 1,000,000 lekë ka sponsorizuar sportistin e nivelit të lartë për merita në sport, me initiale “C.D.”, dhe e gjithë shuma i është dhënë në maj 2026;

- 200,000 lekë ka sponsorizuar një ekip sportiv dhe e gjithë shuma i është dhënë në tetor 2026.

Fitimi i tatueshëm para zbritjes së sponsorizimeve është në shumën 15,000,000 lekë.

Sipas nenit 50, pika 1, shkronja “p” të ligjit, sponsorizimet për veprimtari sportive njihen si shpenzim i zbritshëm deri në masën 5% të fitimit të tatueshëm. Ndërkohë që, të ardhurat që përfiton një person fizik nga sponsorizimet përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale vetëm deri në masën e këtij kufizimi.

1. Sponsorizuesi përcakton kufirin maksimal të zbritshëm për sponsorizuesin

5% e 15,000,000 lekëve = 750,000 lekë.

Pra, shuma maksimale që shoqëria “A.B.” sh.p.k. mund të njohë si shpenzim të zbritshëm për sponsorizime është 750,000 lekë.

2. Përcaktimi i shumës totale të sponsorizimit

Gjatë vitit 2026, shoqëria “A.B.” sh.p.k. ka sponsorizuar veprimtari sportive në shumën 1,200,000 lekë (1,000,000 lekë + 200,000 lekë).

3. Përcaktimi i pjesës së njohur dhe të panjohur si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin

Nga shuma totale prej 1,200,000 lekësh:

a) 750,000 lekë njihen si shpenzim i zbritshëm (brenda kufirit 5%);

b) 450,000 lekë tejkalojnë kufirin ligjor dhe nuk njihen si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin.



4. Çfarë duhet të përcaktohet në vërtetimin e sponsorizuesit për përfituesin sportist me initiale “C.D.”?	Në vërtetimin e sponsorizuesit për përfituesin me initiale “C.D.” përcaktohet: a) Shuma totale e sponsorimit ndaj përfituesit në vlerën 1,000,000 lekë; si dhe b) Shuma e këtij sponsorizimi që do të njihet si e ardhur e përjashtuar dhe cila do të tatohet plotësisht: i. 625,000 lekë përcaktohen të ardhurat e përjashtuara nga tatimi për përfituesin $[(750,000 \text{ lekë} / 1,200,000 \text{ lekë}) * 1,000,000 \text{ lekë}]$; si dhe ii. 375,000 lekë përcaktohen të ardhura e tatueshme për përfituesin $(1,000,000 \text{ lekë} - 625,000 \text{ lekë})$.
5. Çfarë ndodh nëse sportisti me initiale “C.D.” (përfituesi) ka mungesë dokumentacioni?	Nëse sportisti nuk disponon dokumentacionin e kërkuar, përfshirë vërtetimin mbi shumën e njohur si shpenzim i zbritshëm nga sponsorizuesi, e gjithë shuma prej 1,000,000 lekësh konsiderohet e ardhur e tatueshme.
6. Çfarë ndodh me ekipin sportiv?	Në vërtetimin e sponsorizuesit për përfituesin ekip sportiv (sipas pikës 40.1.1 të këtij udhëzimi) përcaktohet: a) Shuma totale e sponsorimit ndaj përfituesit në vlerën 200,000 lekë; si dhe b) Shuma e këtij sponsorizimi do të njihet si e ardhur e përjashtuar dhe cila do të tatohet plotësisht: i. 125,000 lekë përcaktohen të ardhurat e përjashtuara nga tatimi për ekipin sportiv $[(750,000 \text{ lekë} / 1,200,000 \text{ lekë}) * 200,000 \text{ lekë}]$; si dhe ii. 75,000 lekë përcaktohen të ardhura e tatueshme për ekipin sportiv $(200,000 \text{ lekë} - 125,000 \text{ lekë})$.

3. Pas pikës 12.8, shtohet pika 12.8.1 me përmbajtjen, si më poshtë:

“12.8.1 Rregulli i mësipërm nuk zbatohet në rastin kur individ i vetëpunësuar, pavarësisht se të ardhurat e tij plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjën “ç”, nënparagrafët “i” dhe/ose “u” të pikës 1 të nenit 12 të ligjit, vetëdeklararon se nuk ndodhet në kushtet e të ardhurave nga punësimi.

Vetëdeklarimi kryhet nëpërmjet “Deklaratës së Statusit të Vetëpunësuarit”, sipas modelit në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur ligjit, e cila dorëzohet pranë drejtorisë tatimore rajonale ku është i regjistruar tatimpaguesi, dhe shoqëron Deklaratën e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi që dorëzohet brenda muajit mars të vitit pasardhës, përfshirë edhe deklaratën e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi që do të dorëzohet brenda datës 31 mars 2026.

Deklarata e Statusit të Vetëpunësuarit shërben si mjet vlerësimi nga administrata tatimore, në përputhje me ligjin për procedurat tatimore, për të përcaktuar nëse individ i vetëpunësuar nuk ndodhet në kushtet e shmangies tatimore.

Në rast se gjatë verifikimeve apo kontroleve, administrata tatimore pas analizimit të sjelljes së të vetëpunësuarit; kontrollit mbi faktorët dhe produktin e shërbimit si dhe natyrës së marrëdhënies, konstaton se një tatimpagues i vetëpunësuar, i cili mund të ketë dorëzuar ose jo “Deklaratën e statusit të vetëpunësuarit”, ofron shërbime të cilat rezultojnë në situatë shmangie tatimore, të ardhurat e tatimpaguesit të vetëpunësuar të vetëdeklaruar si të ardhura nga biznesi do të konsiderohen si të ardhura nga punësimi.

Administrata tatimore ka të drejtën e rikarakterizimit të të ardhurave në rast se deklarimi është i pasaktë. Rivlerësimi në këto raste bëhet sipas parashikimeve të dispozitave rregulluese për procedurat tatimore.

Shembulli 1

Një individ i vetëpunësuar, i regjistruar me aktivitet “Shërbime për shfaqje artistike”, gjatë vitit tatimor 2025 realizon të ardhura bruto në shumën 3,500,000 lekë. Nga këto të ardhura, 2,900,000 lekë, ose rreth 83% e totalit, realizohen nga një klient i vetëm rezident tatimor në Republikën e Shqipërisë, ndërsa pjesa tjetër e të ardhurave realizohet nga dy klientë të tjerë të ndryshëm.

Referuar shkronjës “ç”, pika 1, e nenit 12 të ligjit, ky individ do të plotësojë kriterin për t’u trajtuar si e ardhur nga punësimi për qëllime tatimore. Megjithatë, individ i vetëpunësuar, duke vlerësuar rrethanat konkrete të marrëdhënies ekonomike me klientin, dorëzon pranë drejtorisë tatimore rajonale Deklaratën e Statusit të Vetëpunësuarit, në të cilën vetëdeklararon se nuk ndodhet në kushtet e të ardhurave nga punësimi.

Deklarata dorëzohet brenda muajit mars, së bashku me Deklaratën Vjetore të Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi. Në këtë rast, deri në një vlerësim të kundërt nga administrata tatimore, të ardhurat e individit të vetëpunësuar trajtohen si të ardhura nga biznesi, dhe individ plotëson rubrikat përkatëse të të ardhurave nga biznesi në Deklaratën Tatimore Vjetore të Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi.

Administrata tatimore, në ushtrim të kompetencave të saj në zbatim të ligjit për procedurat tatimore, përdor Deklaratën



e Statusit të Vetëpunësuarit si mjet vlerësimi për verifikimin e mëtejshëm për të përcaktuar nëse ky tatimpagues është apo jo në kushtet e shmangies tatimore.

Shembulli 2

Një doktor me initiale “A.N.” është i vetëpunësuar, ka një kontratë shërbimi me një spital dhe përfiton të ardhura vjetore prej 200.000 lekësh, sipas faturimit që kryen kundrejt spitalit. Gjatë ushtrimit të detyrës ai përdor pajisjet e spitalit (aparatura, sallat, zyrtat, materialet mjekësore) pa investuar vetë. Pacientët që mjekon i siguron spitali, nuk i sjell ai vetë. Ai e ushtron detyrën në orarin e përcaktuar nga spitali. Spitali mbikëqyr punën e tij dhe vendos rregullat që ai duhet të ndjekë gjatë ushtrimit të detyrës sipas rregulloreve të spitalit.

Pra, pavarësisht se doktori “A.N.” sillet si një vetëpunësuar, në fakt sjellja e tij është e njëjtë me atë të një të punësuar pasi ai është i varur nga spitali për punën dhe mjetet, ai nuk mbart risk financiar, prandaj për qëllime tatimore ai do të trajtohet si punonjës i spitalit.

Shembulli 3

Një kuzhinier me initiale “B.C.” ushtron profesionin si i vetëpunësuar në restorantin “Z” dhe nuk mund ta delegojë apo zëvendësojë me dikë tjetër veten e tij. Restoranti ku ai punon, ka investuar mbi të gjitha pajisjet e kuzhinës dhe furnizon të gjitha materialet që i duhen kuzhinierit “B.C.” për të kryer punën e tij. Gjithashtu, restoranti ka përcaktuar dhe orarin dhe ditët e punës të kuzhinierit “B.C.” Ai paguhet me pagë fikse mujore 250,000 lekë pavarësisht qarkullimit që kryhet në restorant, sipas kontratës që ka me restorantin.

Pra, kuzhinieri “B.C.” në këtë rast është një punonjës i restorantit, pavarësisht sjelljes së tij si i vetëpunësuar, për arsye se sjellja e tij është e njëjtë me atë të një punonjësi, ai nuk mbart risk dhe puna e tij kontrollohet tërësisht nga restoranti.

Shembulli 4

Personi i vetëpunësuar me initiale “E.D.” është një shkrimtar. Ai përdor mjetet e veta (kompjuter, printer etj.) për shkrimet e tij. Punën ai e kryen në ambientet e shtëpisë së tij dhe orarin e punës e ka të papërcaktuar. Shkrimet e tij mund të jenë në formë të ndryshme (si libër apo artikuj të ndryshëm). Për çdo shkrim të tij, ai merr pagesën përkatëse, sipas marrëveshjes që bën me shtëpinë botuese apo redaksinë që ai zgjedh vetë.

Ky shkrimtar në këtë rast është kontraktor i pavarur, për arsye se e gjithë puna bazohet në krijimtarinë e tij të pavarur dhe nuk kontrollohet apo drejtohet nga një shtëpi botuese apo redaksi, dhe në këtë mënyrë është ai që mbart dhe riskun e të ardhurave të tij.

Shembulli 5

Arditi, një hidraulik me përvojë, ka rënë dakord me një kompani për të kryer shërbime me kohë të plotë në kantieret e ndërtimit si i vetëpunësuar. Ai përdor mjetet e tij personale

dhe kryen punën sipas rendit dhe specifikimeve të përcaktuara nga kompania. Kompania furnizon të gjitha materialet, kryen inspektime të shpeshta të punës së tij, e paguan atë sipas sasisë së punës së kryer. Arditi nuk ka një vendndodhje biznesi dhe nuk kërkon të ofrojë shërbime të ngjashme për palë të tjera. Të dyja palët mund ta ndërpresin marrëdhënien në çdo kohë.

Arditi në këtë rast është qartësisht një punonjës i kompanisë, pasi e gjithë puna e tij drejtohet nga kompania, ai nuk mbart risk financiar. Pavarësisht se ai përdor mjetet e tij personale në kryerjen e punës dhe faturon kompaninë për çdo shërbim të tij, është kompania ajo që i siguron atij punën, kontrollojnë cilësinë e saj, furnizon Arditi me të gjitha materialet e nevojshme dhe është e vetmja kompani me të cilën Arditi operon.”.

4. Në pikën 20.1, pas togfjalëshit “agjenti i mbajtjes së tatimit në burim” shtohet togfjalëshi “, pavarësisht nëse derdha e kontributit bëhet nga punëdhënësi, nga punëmarrësi apo nga çdo kontribues tjetër për llogari të punëmarrësit”.

5. Në pikën 30, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Në pikën 30.2, togfjalëshi “duke i shtuar të ardhurave që i nënshtrohen tatimit”, zëvendësohet me togfjalëshin “duke i shtuar fitimit para tatimit”.

b) Në pikën 30.4, togfjalëshi “EBITDA = fitimi i tatueshëm”, zëvendësohet me togfjalëshin “EBITDA = fitimi”.

6. Pas pikës 40.1, shtohet pika 40.1.1 me përmbajtjen, si më poshtë:

“40.1.1 Nuk do të konsiderohen të ardhura të tatueshme të ardhurat që përfiton një entitet nga sponsorizimet deri në masën e kufizimeve të përcaktuara në nenin 50, pika 1, shkronja “p” të ligjit.

Përfashtimi zbatohet vetëm për pjesën e sponsorizimit që plotëson kushtet dhe kufizimet ligjore për njohjen si shpenzim i zbritshëm të sponsorizimit nga sponsorizuesi. Çdo shumë që tejkalon kufirin e lejuar sipas dispozitës së sipërcituar konsiderohet e ardhur e tatueshme dhe i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat e korporatave, sipas dispozitave ligjore.

Për qëllime të zbatimit të kësaj dispozite, entiteti përfitues duhet të disponojë dhe, me kërkesë të administratës tatimore, të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) kontratën e sponsorizimit të lidhur ndërmjet sponsorizuesit dhe entitetit përfitues, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sponsorizimet;

b) dokumentin bankar që provon kryerjen e pagesës së sponsorizimit ose fatura e shitjes së mallit në vlerën e kostos;

c) vërtetim nga sponsorizuesi mbi shumën e sponsorizimit të njohur si shpenzim i zbritshëm, sipas kufizimeve të nenit 50, pika 1, shkronja “p” të ligjit. Ky vërtetim i dorëzohet përfituesit për qëllime të kryerjes së deklarimit dhe duhet të përcaktojë:



i. shumën e sponsorizimit që njihet si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin, e cila korrespondon me shumën që do t'i njihet përfutuesit si e ardhur e përjashtuar; si dhe

ii. në rast se sponsorizimi tejkalon kufizimet ligjore, shumën që nuk njihet si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin, e cila korrespondon me pjesën e sponsorizimit që i njihet përfutuesit si e ardhur e tatueshme.

d) çdo dokument tjetër mbështetës që mund të ketë, që provon natyrën dhe përputhshmërinë ligjore të sponsorizimit.

Në mungesë të dokumentacionit të plotë dhe të vlefshëm, ose kur konstatohet se nuk plotësohen kufizimet ligjore për njohjen e sponsorizimit si shpenzim i zbritshëm për sponsorizuesin, e gjithë shuma ose pjesa përkatëse konsiderohet e ardhur e tatueshme.”

7. Në pikën 50.1, shkronja “v” bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë:

a) Në nënparagrafin “ii”, togfjalëshi “si dhe ekipet kombëtare të organizuara nga federatat shqiptare” zëvendësohet me togfjalëshin “organizatave sportive, komiteteve olimpike, ekipet kombëtare të organizuara nga federatat shqiptare, ekipet kombëtare të organizuara nga federatat shqiptare, si dhe sportistët e nivelit të lartë që kanë fituar tituj për meritë në sport,”;

b) Nënparagrafi “iii” ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“iii. deri në masën 5 për qind të fitimit para tatimit për sponsorizimin e aktiviteteve për kërkim dhe zhvillim, të cilat ndërmerren me qëllim përfitim të njohurive të reja për zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë dhe aplikimin e tyre nëpërmjet inovacionit në produkte ose shërbime.”;

c) Pas nënparagrafit “iii” shtohet nënparagrafi “iv” me përmbajtje, si më poshtë:

“iv. deri në masën 3 për qind të fitimit para tatimit për sponsorizimet e veprimtarive të tjera, që nuk përfshihen në nënparagrafët “i”, “ii” dhe “iii” më sipër.”;

d) Në paragrafin e parë, pas nënparagrafit “iv”, pas togfjalëshit me përmbajtje: “Për tatimpaguesit, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë, shumat e sponsorizuara për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive,” shtohet togfjalëshi me përmbajtje: “organizatave sportive, komiteteve olimpike, ekipeve kombëtare të organizuara nga federatat shqiptare, si dhe sportistëve të nivelit të lartë që kanë fituar tituj për meritë në sport,”.

8. Pas pikës 66.1, shtohet pika 66.1.1 me përmbajtje si më poshtë:

“66.1.1 Në rastet kur punëmarrësi ka më shumë se një punësim dhe njëri prej tyre është në administratë shtetërore, për qëllime të aplikimit të zbritjeve mujore përmes sistemit të

centralizuar të pagesave, deklarata e statusit personal paraqitet pranë punëdhënësit në administratën shtetërore.”.

9. Në aneksin nr. 2 të projektudhëzimit bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në formularin “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, në rubrikën nr. 26 me titull: “Shuma që zbritet nga paga dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit”, bëhet riformulim i titullit me përmbajtje “Shuma që zbritet nga paga dhe derdhet nga punëdhënësi/punëmarrësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit”.

b) Në “Udhëzuesi i plotësimit të listëpagesës...”, pika 26 e udhëzuesit, riformulohet, si më poshtë:

“26. Shuma që zbritet nga paga dhe derdhet nga punëdhënësi/punëmarrësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit – zbritet nga të ardhurat personale të të punësuarit për efekt tatimi. Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të një fondi pensioni, për efekte fiskale, nuk vlerësohen si të ardhura personale të anëtarit. Shuma që zbritet nga paga si kontribut për punëmarrësin në fondet e pensionit vullnetar nuk dubet të jetë më e madhe se paga minimale në shkallë vendi. Për zbritjet e bëra, punëdhënësi dubet të disponojë dokumentacion justifikues, si:

a) Kontratën e lidhur me fondin e pensionit vullnetar;

b) Vërtetimin/dokument të lëshuar nga fondi i pensionit vullnetar, i cili vërteton që këto zbritje janë derdhur si pagesë në këtë fond. Vërtetimi dorëzohet një herë në vit për të gjithë vitin tatimor në të cilin derdhen kontributet në fondin e pensionit, brenda datës 20 janar të vitit pasardhës.

Ky dokumentacion dubet të administrohet në çdo kohë dhe të vihet në dispozicion të administratës tatimore nëse kërkohet.”.

10. Në pikën 61.6, pas togfjalëshit “si dhe në sistemin e-Tax”, shtohet togfjalëshi: “sipas afateve të dorëzimit të deklaratës përkatëse.

11. Kudo në përmbajtje të udhëzimit, togfjalëshi “mjete virtuale” zëvendësohet me togfjalëshin “kripto-aset”.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj



URDHËR

Nr. 168, datë 13.3.2026

**PËR ZËVENDËSIMIN E PËRKOHSHËM
PËR NËNSHKRIMIN E
DOKUMENTEVE NË EMËR TË
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të pikës 3 të nenit 15 të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Z. Alqi Kushi, drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Inovacionit dhe Teknologjisë, që në mungesë dhe me porosi, të zëvendësojë për nënshkrimin e korrespondencave të përditshme shkresore, që janë kompetencë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

2. Gjatë periudhës së zëvendësimit të shqyrtojë dhe të miratojë çdo akt që kalon nëpërmjet sistemit *e-Aktet*, në emër dhe për llogari të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

3. Gjatë periudhës së zëvendësimit të nënshkruajë elektronikisht, në emër dhe për llogari të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, në sistemin AFMIS dhe miratimin në sistemin SIFQ.

4. Periudha e zëvendësimit është e vlefshme për periudhën 16.3.2026 deri më 20.3.2026.

5. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Inovacionit dhe Teknologjisë, z. Alqi Kushi për zbatimin e këtij urdhri, si dhe sektori i Arkiv-Protokollit për komunikimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË SË EKONOMISË DHE
INOVACIONIT
Suzana Hoxha

URDHËR

Nr. 239, datë 5.3.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produkteve të mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65°C në 39.8 sekonda;

ii. 70 °C në 3.6 sekonda;

iii. 74 °C në 0.5 sekonda;

iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Bayern	Erding	Steinkirchen*
2.	Brandenburg	Oder-Spree	Neuzelle*



3.	Bayern	Erding	Bockhorn*
4.	Brandenburg	Dahme-Spreewald	Bestensee*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Gjermanisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 222, datë 2.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR Nr. 240, datë 5.3.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HOLANDËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1.	Drenthe	Aa en Hunze*
2.	Gelderland	Barneveld*
3.	Gelderland	Kesteren*
4.	Gelderland	Hummelo en Keppel*
5.	Flevoland	Noordoostpolder*
6.	Friesland	Achtkarspelen*
7.	Gelderland	Ede*
8.	Flevoland	Dronten*
9.	Noord-Holland	Beverwijk*
10.	Groningen	Delfzijl*
11.	Zuid-Holland	Dordrecht*
12.	Zeeland	Hulst*



13.	Limburg	Meerlo-Wanssum*
14.	Limburg	Helden*
15.	Overijssel	Wierden*
16.	Flevoland	Zeewolde*
17.	Gelderland	Nijkerk*
18.	Gelderland	Harderwijk*
19.	Drenthe	Coevorden*
20.	Gelderland	Ermelo*
21.	Noord-Brabant	Woudrichem*
22.	Limburg	Venray*
23.	Noord-Brabant	Deurne*
24.	Noord-Brabant	Oisterwijk*
25.	Zuid-Holland	Maasland*
26.	Gelderland	Buren*
27.	Overijssel	Almelo*
28.	Groningen	Stadskanaal*
29.	Friesland	Dongeradeel*
30.	Groningen	Eemsmond*
31.	Utrecht	Renswoude*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 190, datë 23.2.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i

Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 280, datë 12.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Për shkak të angazhimeve për të garantuar vijimësinë e veprimtarisë administrative të Ministrisë, delegoj të drejtën e firmës për të gjitha dokumentet dhe aktet që lidhen me procedurat e importeve në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit z. Fatmir Guri, për periudhën 12 mars 2026 deri më 31 mars 2026.

2. Zëvendësministri i përmendur në pikën 1 është i autorizuar të nënshkruajë në emër të ministrit dokumentet që lidhen me importet, si më poshtë:

- Kërkesat dhe miratimet për importe, sipas kompetencës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

- Autorizimet, vërtetimet dhe shkresat zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore dhe subjekteve private, për çështje që lidhen me importet;

- Çdo dokument tjetër administrativ, që kërkon firmën e ministrit në fushën e importeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ky delegim është i vlefshëm vetëm për periudhën 12 mars 2026 deri më 31 mars 2026. Pas kësaj date e drejta e firmës kthehet te ministri, sipas kompetencave të tij të plota ligjore.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative, drejtoria përgjegjëse për importet



dhe të gjitha strukturat e tjera përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

5. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, 1 (një) për arkiv-protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin, sipas pikës 1.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

VENDIM
Nr. 56, datë 20.2.2026

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË
FUNDIT, PËR KLIENTËT E LIDHUR
NË NIVELIN E TENSIONIT 20/10/6 kV,
PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 678/1 prot., datë 18.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2026” dhe informacionin shitesë me nr. 678/4 prot., datë 19.2.2026, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV për vitin 2026”,

konstatoi se:

- Në përputhje me nenin 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar,

ERE, ka kompetencë të miratojë tarifat dhe çmimet e rregulluara për të licencuarit që ushtrojnë aktivitete në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me metodologjitë e miratuara prej tij.

- KESH sh.a., më datë 18.2.2026, dërgoi në ERE “Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 1212/1 prot., datë 6.2.2026, për vitin 2026”, i cili përcaktonte çmimin mesatar të shitjes së energjisë për sasinë e kontraktuar për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV (prej 12.00 lekë/kWh), për vitin 2026.

- FSHU sh.a., me shkresën me nr. 678/3 prot., datë 19.2.2026, paraqiti aplikimin mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2026 për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit të lidhur në nivelin e tensionit 6/10/20 kV, si dhe për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV, bashkëlidhur të cilit gjendej dhe “Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit të KESH sh.a. nr. 1212/1 prot., datë 6.2.2026”.

- Në aplikimin e përcjellë, FSHU sh.a. cilëson klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV si klientë të rëndësishëm të veçantë ku kosto e blerjes së energjisë elektrike do të jetë 12.00 lekë/kWh.

- Në “Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit” me nr. 1212/1 prot., datë 6.2.2026, evidentohet që kosto e blerjes së energjisë elektrike për qëllime të Furnizimit të Mundësisë së Fundit do të jetë e aplikueshme për të gjithë klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët do të shërbejnë në kushtet e mundësisë së fundit do të jetë 12 lekë/kWh për të gjithë vitin 2026.

- Komponentët e përdorur për përlllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV edhe për vitin 2026 do të vijojë të jetë 12.00 lekë/kWh, bazuar në vendimin e Asamblesë së përgjithshme të Aksionarit nr. 1212/1 prot., datë 6.2.2026, të KESH sh.a.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027” prej 0.85 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelet e tensionit 20/10/6 kV, në zbatim të vendimit të



Bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022”, është 3.99 lekë.

- Kostot administrative, të cilat vijnë të jenë 1.06 lekë/kWh.

- Kthimi për riskun prej 3% (i aplikuar mbi çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës për energji elektrike) në vlerën 0.36 lekë/kWh për kategorinë e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” dhe të dhënave në dispozicion në përlogaritjet e kryera nga ERE rezultojnë se çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së fundit për vitin 2026, për klientët e rëndësishëm të veçantë të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, paraqitet në tabelën në vijim:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2026		
	Njësia	Çmimi
ÇBET Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	12.00
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3 %)	Lekë/kWh	0.36
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	3.99
Çmimi i energjisë = ÇBET + Pr * ÇBET + TRr + TSHt + CA	Lekë/kWh	18.26

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2026, prej 18.26 lekë/kWh, për klientët e rëndësishëm të veçantë të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

2. Çdo ndryshim në elementet përbërëse të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë FSHU sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

VENDIM
Nr. 57, datë 20.2.2026

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR SHOQËRITË UJËSJELLËS-KANALIZIME TË LIDHURA NË NIVELIN E TENSIONIT 6/10/20/35 kV, PËR VITIN 2026

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë



17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 678/2 prot., datë 18.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV, për vitin 2026” dhe informacionin shtesë me nr. 678/4 prot., datë 19.2.2026, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV, për vitin 2026”,

konstatoi se:

- Shoqëritë ujësjellës-kanalizime gëzojnë status të veçantë në kuptim të nenit 8, pikat 1 dhe 2, të VKM-së nr. 456/2022, të ndryshuar, si subjekte që sigurojnë furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe që, në kuadër të detyrimit të shërbimit publik, përfitojnë furnizim të pandërprerë me energji elektrike. Në zbatim të kësaj dispozite, Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. ka detyrimin të garantojë pa ndërprerje furnizimin me energji elektrike për këto subjekte, ndërsa edhe në rast se ato kanë dalë në treg të liberalizuar dhe furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, u sigurohet vazhdimësia e furnizimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- KESH sh.a., më datë 18.2.2026, dërgoi në ERE “Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 1212/1 prot., datë 6.2.2026, për vitin 2026”, i cili përcakton çmimin mesatar të shitjes së energjisë për sasinë e kontraktuar për shoqëritë ujësjellës-kanalizime në nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV (prej 5.70 lekë/kwh), për vitin 2026.

- FSHU sh.a., me shkresën me nr. 678/3 prot., datë 19.2.2026, përcolli në ERE aplikimin mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2026 për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, të lidhur në

nivelin e tensionit 6/10/20 kV, si dhe për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV, bashkëlidhur të cilit gjendej dhe “Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit të KESH sh.a., nr. 1212/1 prot., datë 6.2.2026”.

- Komponentët e përdorur për përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin 6/10/20/35 kV edhe për vitin 2026 do të vijojë të jetë 5.70 lekë/kwh, bazuar në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr.1212/1 prot., datë 6.2.2026, të KESH sh.a.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027” prej 0.85 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelet e tensionit 20/10/6 kV dhe 35 kV në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”, është 3.99 lekë për nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe 1.55 lekë/kwh për nivelin e tensionit 35 kV.

- Kostot administrative, të cilat vijojnë të jenë 1.06 lekë/kwh.

- Kthimi për riskun prej 3% (i aplikuar mbi çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës për energji elektrike) në vlerën 0.17 lekë/kwh për kategorinë ujësjellës-kanalizime.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” dhe të dhënave në dispozicion në përlogaritjet e kryera nga ERE, rezultoi se çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së fundit për vitin 2026, për shoqëritë ujësjellës-kanalizime 6/10/20/35 kV, paraqitet në tabelën në vijim:



Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime për vitin 2026			
Viti 2026		Nivelet e tensionit	
		35 kV	20/10/6 kV
ÇBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Njësia	Çmimi
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3 %)	Lekë/kWh	5.70
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	0.17
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	1.06
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	0.85
		Lekë/kWh	1.55
		Lekë/kWh	3.99
Çmimi i energjisë = ÇBEt + Pr * ÇBEt + TRr + TSHt + CA		Lekë/kWh	9.33
		Lekë/kWh	11.77

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDIM
Nr. 58, datë 20.2.2026

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2026, prej 9.33 lekë/kwh për shoqëritë ujësjetllës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2026, prej 11.77 lekë/kwh për shoqëritë ujësjetllës-kanalizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV.

3. Çdo ndryshim në elementët përbërës të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë ujësjetllës-kanalizime, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

4. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë FSHU sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE TË NISUR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 35,
DATË 4.2.2026, “MBI FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR HEQJEN E
LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË
‘HEC TRESKA’ SHPK ME VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 80,
DATË 24.7.2013”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 95 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të neneve 7, 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin shtesë me nr. 453/2 prot., datë 18.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi përfundimin e procedurave administrative të nisura për heqjen e licencave të shoqërive ‘HEC Treska’ sh.p.k., ‘Hydropower Plant of Korca’ sh.p.k. dhe ‘Peshku-Picar 1’ sh.p.k.”.

konstatoi se:



- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 35, datë 4.2.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HEC Treska” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 24.7.2013.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare të ERE-s, rezulton se shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj brenda afatit 30-ditor të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së saj.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, parashikohet se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës.”.

- Në nenin 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”.

- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktik, konkretisht shlyerjes së plotë të detyrimit financiar nga ana e shoqërisë. Vërtetimi i pagesës së prapambetur konfirmon se nuk ekzistojnë kushtet që çuan në nisjen e procedurës për heqjen e licencës, pasi objekti për të cilin është nisur kjo procedurë nuk ekziston më.

- Në këto kushte, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2026. Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2026, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e

licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘HEC Treska’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 24.7.2013”.

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit nr. 35, datë 4.2.2026.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës të njoftojë shoqërinë “HEC Treska” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 59, datë 20.2.2026

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 36, DATË 4.2.2026, “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË ‘HYDRO POWER PLANT OF KORCA’ SHPK ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 38, DATË 5.4.2012”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 95 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të neneve 7, 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe



procedurave të ERE-s”; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453/2 prot., datë 18.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi përfundimin e procedurave administrative të nisura për heqjen e licencave të shoqërive ‘HEC Treska’ sh.p.k., ‘Hydro Power Plant of Korca’ sh.p.k. dhe ‘Peshku-Picar 1’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 36, datë 4.2.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 154, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 5.4.2012.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare të ERE-s, rezulton se shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj brenda afatit 30-ditor të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së saj.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”; parashikohet se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës.”.

- Në nenin 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”.

- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktik, konkretisht shlyerjes së plotë të detyrimit financiar nga ana e shoqërisë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k. Vërtetimi i pagesës së prapambetur konfirmon se nuk ekzistojnë kushtet që çuan në nisjen e procedurës për heqjen e licencës, pasi objekti për të cilin është nisur kjo procedurë nuk ekziston më.

- Në këto kushte, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 36, datë 4.2.2026. Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së

Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin nr. 36, datë 4.2.2026, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 154, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Hydro Power Plant of Korca’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 5.4.2012”.

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit nr. 36, datë 4.2.2026.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 60, datë 20.2.2026**

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE TË NISUR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 39,
DATË 4.2.2026, “MBI FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR HEQJEN E
LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË
‘PESHKU-PICAR 1’ SHPK, ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 24, DATË 2.3.2012”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 95 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 7, 8 dhe 9 të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin shtesë me nr. 453/2 prot., datë 18.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi përfundimin e procedurave administrative të nisura për heqjen e licencave të shoqërive ‘HEC Treska’ sh.p.k., ‘Hydropower Plant of Korca’ sh.p.k. dhe ‘PESHKU-PICAR 1’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 39, datë 4.2.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 156, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Peshku-Picar 1” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 2.3.2012.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare të ERE-s, rezulton se shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj brenda afatit 30-ditor të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së saj.

- Në nenin 9, germa “a”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”,

parashikohet, se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat” sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës”.

- Në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet, se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur, për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktik, konkretisht shlyerjes së plotë të detyrimit financiar nga ana e shoqërisë. Vërtetimi i pagesës së prapambetur konfirmon se nuk ekzistojnë kushtet që çuan në nisjen e procedurës për heqjen e licencës, pasi objekti për të cilin është nisur kjo procedurë nuk ekziston më.

- Në këto kushte, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 39, datë 4.2.2026. Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 39, datë 4.2.2026, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 156, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Peshku-Picar 1’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 2.3.2012”.

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit nr. 39, datë 4.2.2026.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “peshku-Picar 1” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data



e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 61, datë 26.2.2026

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“PROINFINIT CONSULTING” SHPK
PËR HEQJEN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “dh”, 7, paragrafët 2 dhe 9, germa “d”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të pikës 5.1, germa “dh”, të Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 468/1 prot., datë 24.2.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “Proinfinet Consulting” sh.p.k. për heqjen e licencave në veprimtarinë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Proinfinet Consulting” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 557, seria F23, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 6.6.2023, për një afat 5-vjeçar (deri më 6.6.2028).

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 468 prot., datë 3.2.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për revokimin e kësaj licence, për arsye se nuk e ka ushtruar veprimtarinë e licencuar.

- Në nenin 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenin 5, germa “dh”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.4.2017; dhe të pikës 9.1, germa “a”, të kushteve të licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 17.6.2016, përcaktohet se ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit.

- Në nenin 7, paragrafi 2 i rregullores së sipërcituar përcaktohet se: “Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat ‘dh’ dhe/ose ‘e’, të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje, ndërsa në nenin 9, germa ‘d’ të kësaj rregulloreje parashikohet se ... Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat ‘dh’ dhe/ose ‘e’, të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7, paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.”.

- Rezulton se shoqëria nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s sa i përket pagesave të rregullimit.

- Për këto arsye dhe në rrethanat kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, vlerësohet të vijohet me miratimin e saj dhe heqjen e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e shoqërisë “Proinfinet Consulting” sh.p.k. e humbet fuqinë juridike dhe hiqet dhe nga regjistri i licencave.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Proinfinet Consulting” sh.p.k., për heqjen e licencës nr. 557, seria F23, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 6.6.2023, për një afat 5-vjeçar.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar e humbet fuqinë juridike.



3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., “OST” sh.a., “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 62, datë 26.2.2026

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“PROINFINIT CONSULTING” SHPK
PËR HEQJEN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “dh”, 7, paragrafët 2 dhe 9, germa “d”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të pikës 5.1, germa “dh”, të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 468/1 prot., datë 26.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Proinfinit Consulting’ sh.p.k.

për heqjen e licencave në veprimtarinë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 558, seria T23, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 6.6.2023, për një afat 5-vjeçar (deri më 6.6.2028).

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 468 prot., datë 3.2.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për revokimin e kësaj licence, për arsye se nuk e ka ushtruar veprimtarinë e licencuar.

- Në nenin 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenin 5, germa “dh”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.4.2017; të pikës 5.1, germa “dh”, të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, përcaktohet se: “ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit.”.

- Në nenin 7, paragrafi 2 i rregullores së sipërcituar përcaktohet se: “Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e”, të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje, ndërsa në nenin 9, germa “d”, të kësaj rregulloreje parashikohet se ...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “dh” dhe/ose “e”, të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7, paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.

- Rezulton se shoqëria nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s sa i përket pagesave të rregullimit.

- Për këto arsye dhe në rrethanat kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, vlerësohet të vijohet me miratimin e saj dhe heqjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. e humbet fuqinë juridike dhe hiqet dhe nga regjistri i licencave.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., për heqjen e licencës nr. 558, seria T23, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr.188, datë 6.6.2023, për një afat 5-vjeçar.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar e humbet fuqinë juridike.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., “OST” sh.a., “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 63, datë 26.2.2026

**MBI LLOGARITJEN E PAGESAVE
RREGULLATORE PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 17, pika 4, nenit 20, germa “d”, nenit 35, pika 1, neneve 45 dhe 46, nenit 51, pika 2, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 14 dhe 30, pika 3, nenit 31, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 5, pikat 5.2, 5.3 dhe 5.4, nenit 6, pikat 6.1, 6.1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”, 6.2, 6.3 dhe 6.4, të rregullores “Mbi përcaktimin e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 190, datë 23.11.2017, të ndryshuar; neneve 15, 16 dhe 17 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e

Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, të ndryshuar; si dhe pikës 2 të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, të Bordit të ERE-s, “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2025”;

Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin nr. 721 prot., datë 24.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2026”,

konstatoi se:

- ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloren përkatëse.

- Pagesat rregullatore për vitin 2026 janë përlllogaritur në zbatim të nenit 6 të rregullores “Për përcaktimin dhe miratimin e pagesave rregullatore”, mbi bazën e pagesës rregullatore specifike për secilin të licencuar, ku, sipas pikës 6.1, llogaritja është kryer duke përcaktuar peshën specifike të të ardhurave të realizuara nga aktiviteti i licencuar gjatë vitit 2025, ndaj totalit të të ardhurave të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror për të njëjtën periudhë (të ardhurat sipas pikës 6.1.1), dhe më tej, në zbatim të pikës 6.2, pagesa rregullatore për secilin të licencuar është përlllogaritur si produkt i kësaj peshe specifike me vlerën për t'u shpërndarë në buxhetin e ERE-s, pasi janë zbritur pagesat fikse të parashikuara nga rregullorja.

- Vlera totale për efekt të llogaritjes së pagesës rregullatore për vitin 2026 është përcaktuar bazuar në vendimin nr. 352, datë 29.12.2025, të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028 dhe buxhetit të ERE-s për vitin 2026”, si dhe dokumentin informues të relatuar në mbledhjen e Bordit të ERE-s nr. 3, datë 26.1.2026.

- Me qëllim mbledhjen e të dhënave për përlllogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2026, ERE, me shkresat e protokolluara gjatë muajit dhjetor 2025, iu rikujtoi subjekteve të licencuara detyrimin për depozitimin e pasqyrave financiare dhe formularëve të deklarimit të të ardhurave për vitin 2025, duke mbajtur në konsideratë ndarjen në llogari të veçanta për secilën veprimtari të licencuar dhe për çdo aktivitet tjetër jashtë sektorit.

- Për subjektet që kanë depozituar në ERE pasqyrat financiare dhe formularin e deklarimit të të ardhurave për vitin 2025, janë konsideruar të



ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar, në zbatim të dispozitave të rregullores përkatëse.

- Për shoqëritë e licencuara të cilat në vitin paraardhës nuk kanë pasur aktivitet, në përputhje me pikën 6.3 të rregullores, pagesa rregullatore është llogaritur në shumën fikse prej 100,000 (njëqind mijë) lekësh.

- Duke qenë se disa shoqëri nuk kanë përcjellë pasqyrat financiare për vitin 2025, për efekt të përllogaritjes së pagesës rregullatore për vitin 2026 është konsideruar e ardhura e realizuar gjatë vitit 2024.

- Në zbatim të pikës 2 të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, të Bordit të ERE-s, “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2025”, diferencat që rezultojnë nga pasqyrat financiare të certifikuara për vitin 2025 do të konsiderohen në llogaritjen e pagesave të rregullimit të periudhës pasardhëse.

- Pas korrigjimeve të kryera për pagesat rregullatore të vitit 2025, të miratuara me vendimin nr. 112, datë 23.5.2025, është vijuar me evidentimin e të licencuarve që kanë përcjellë në ERE pasqyrat financiare për vitin 2025, vlera e të cilave do të alokohet ndaj pagesave rregullatore rezultuese për vitin 2026.

- Mbështetur në regjistrin e licencave të shkarkuar nga faqja zyrtare e ERE-s, rezultojnë gjithsej 419 të licencuar deri më 31.12.2025, të cilët janë subjekt i pagesave rregullatore, sipas klasifikimit përkatës në prodhim, shpërndarje, transmetim, furnizim, operim tregu dhe tregtim.

- Përllogaritja e pagesave rregullatore për vitin 2026 është kryer duke u bazuar në informacionin e përfutur në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, sipas pikës 5.4 të rregullores, të licencuarit depozitojnë në ERE deri më 31 janar të vitit pasardhës pasqyrat financiare të plota për vitin e mëparshëm ushtrimor dhe deri më 30 qershor kopje të audituar të pasqyrave financiare, nga ku rezulton informacioni mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar që përdoren në llogaritjen e pagesave rregullatore.

- Për të licencuarit që nuk paraqitën dokumentacionin financiar sipas kërkesave, informacioni për përllogaritjen e pagesave rregullatore është përfutur nga raportimet e OSHEE sh.a. lidhur me prodhimin e energjisë elektrike, raportimet e OST sh.a. mbi transaksionet e pjesëmarrësve të tregut, si dhe nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).

- Për subjektet e licencuara në prodhimin e energjisë elektrike që nuk kanë përcjellë pasqyrat financiare, të ardhurat nga aktiviteti ushtrimor janë përllogaritur bazuar në sasinë e energjisë elektrike të prodhuar gjatë vitit 2025, shumëzuar me çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike për prodhuesit ekzistues me përparësi, të miratuar me vendimin nr. 273, datë 13.12.2024, në masën 10 lekë/kwh.

- Për subjektet e licencuara në veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit që nuk paraqitën të dhënat financiare dhe për të cilat nuk ishte i mundur aksesimi i informacionit nga burime të tjera zyrtare, është vlerësuar që të merret e ardhura e realizuar në vitin 2024, ndërsa korrigjimet përkatëse do të aplikohen në pagesën rregullatore të vitit pasardhës, pasi të depozitohen pasqyrat financiare të audituara për vitin 2025, në zbatim të nenit 7 të rregullores.

- Në momentin e depozitimit në ERE të të dhënave mbi aktivitetin e licencuar, do të kryhen korrigjimet përkatëse, sikurse është vepruar në çdo periudhë të mëparshme të përllogaritjes së pagesave rregullatore.

- Është konstatuar se shoqëritë që kanë zhvilluar dy ose më shumë aktivitete të licencuara nuk kanë paraqitur ndarjen e llogarive sipas aktiviteteve, siç përcaktohet në dispozitat ligjore në fuqi.

- Nga analiza e të dhënave të pasqyrave financiare dhe raportimeve të OSSH sh.a. për prodhuesit me përparësi, vërehet se në disa raste të ardhurat e deklaruara për vitin 2025 nuk përputhen me të ardhurat që rezultojnë nga sasia e energjisë elektrike të shitur, bazuar në çmimin vjetor 10 lekë/kwh të miratuar me vendimin nr. 273, datë 13.12.2024; kjo dukuri rregullohet në periudhën pasardhëse për shkak të regjistrimit të faturave të shitjes së energjisë ndaj FTL-së për muajin dhjetor 2025, në muajin janar 2026.

- Për të licencuarit që nuk kanë zhvilluar aktivitet ose që nuk e kanë filluar aktivitetin për të cilin janë licencuar, pagesa rregullatore është llogaritur në shumën fikse prej 100,000 lekësh, në zbatim të pikave 5.2 dhe 6.3 të rregullores.

- E njëjta shumë fikse është zbatuar edhe për shoqëritë që kanë më shumë se një licencë dhe nuk kanë paraqitur pasqyrat financiare të ndara sipas aktiviteteve të licencuara; në rastet kur llogaritë janë paraqitur të konsoliduara, vetëm njërit prej aktiviteteve i është llogaritur pagesa rregullatore nëpërmjet peshës specifike, ndërsa për aktivitetet e tjera është zbatuar tarifa fikse prej 100,000 lekësh.



- Në përlogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2026 janë aplikuar diferencat/korrigjimet që kanë rezultuar nga pasqyrat financiare të certifikuara për vitin 2024, në zbatim të pikës 2 të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, të Bordit të ERE-s, duke sjellë korrigjime përkatëse në pagesat rregullatore rezultuese për vitin 2026, bazuar në të ardhurat e konstatuara në pasqyrat financiare të depozituara në ERE dhe/ose të shkarkuara në QKB.

